



BASHKIA
SHKODËR



Nr _____ datë 02.11 2016
14346

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot më datë _____.____.2016 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve:

1. **Bashkia Shkodër**, me adresë Rruga 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, Shqipëri, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj. Voltana Ademi, këtej e tutje e quajtur “Bashkia”.

2. **Terre des hommes, Misioni në Shqipëri dhe Kosovë**, një fondacion zvicerian me qendër në Lozanë, punon për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa dallim feje, race, gjinie apo përkatësie politike, regjistruar në Gjykatën e Tiranës Shqipëri në vitin 2005, identifikuar me NIPT K62106002A, në përputhje dhe në kuadër të përgjegjësisve të saj si implementuese e projektit “Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe reintegrimi i fëmijëve migrantë në Shqipëri”, të financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim, me adresë: Rruga “Faik Konica”, Tiranë, përfaqësuar nga Znj. Jezerca Tigani, bazuar në Vendimin e Komitetit Ekzekutiv të Bordit të Fondacionit Terre des hommes Lozanë, Zvicër, datë 02.07.2014; këtej e tutje e quajtur “Tdh”.

Palët e mësipërme bien dakord për lidhjen e kësaj marrëveshjeje si më poshtë vijon:

NENI 1 **Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është të përcaktojë angazhimin e ndërsjelltë të palëve dhe vazhdimësinë e bashkëpunimit që nga periudha e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje deri në përfundim të saj, pranë Bashkisë Shkodër me qëllim aksesin në shërbime shoqërore cilësore për garantimin e mbrojtjes, promovimin e të drejtave dhe mirëqënies së fëmijëve dhe familjeve vulnerabël dhe në rrezik në qytetin e Shkodrës, nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve në përputhje me reformën e decentralizimit, reformën territoriale/administrative dhe atë të shërbimeve shoqërore.

Neni 2 **Baza Ligjore**

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, 9, 24, Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimpruese” i ndryshuar, ligjin nr. 10347, datë 04. 11. 2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe cdo ligj tjetër i Republikës së Shqipërisë, që prek drejtpërdrejt apo jo këtë marrëveshje bashkëpunimi.



NENI 3
Parimet e Bashkëpunimit

Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, Palët sigurojnë se gjatë veprimtarisë së tyre do të udhëhiqen nga parimi i ligjshmërisë, mos diskriminimit, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me synim koordinimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, vecanërisht në parandalimin e migrimit të pasigurtë dhe reintegrimin e migrantëve të kthyer.

NENI 4
Objektivat specifike të kësaj marrëveshjeje

1. Planifikimi efektiv i shërbimeve sociale vendore në kuadër të reformës së decentralizimit, reformës territoriale/administrative dhe asaj të shërbimeve shoqërore.
2. Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve të sektorëve dhe disiplinave të ndryshme për të përmirësuar mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve dhe i shërbimeve efektive që aksesohen dhe mbështesin fëmijët në rrezik apo vulnerabël.
3. Ngritja e kapaciteteve të punonjësve socialë në Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Rasteve, pranë bashkisë Shkodër për menaxhimin efektiv të rasteve dhe ofrimin e shërbimeve cilësore.
4. Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe ri-integrimi i fëmijëve migrantë apo të rikthyer nga migracioni dhe familjeve përkatëse.
5. Promovimi i të drejtave të fëmijëve dhe parandalimi i abuzimit të fëmijëve, shfrytëzimit, trafikimit apo ekspozimit në migracion të pasigurtë.
6. Pilotimi i shërbimeve komunitare me në fokus fëmijët dhe aksesin në shërbime cilësore për fëmijët dhe familjet vulnerabël apo në rrezik.
7. Fuqizimi socio-ekonomik i familjeve dhe fëmijëve më vulnerabël.
8. Mbështetja e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) në bashki dhe në njësitë administrative për të garantuar parandalimin, mbrojtjen dhe re-integrimin e fëmijëve të rrezikuar dhe prekur nga abuzimi, dhuna, neglizhimi dhe shfrytëzimi në përputhje me planin individual të ndërhyrjes për fëmijën dhe procesin multidisiplinar të menaxhimit të rastit.

NENI 5
Angazhimet e palëve

4.1 Bashkia merr përsipër:

1. Të promovojë të drejtat e fëmijëve në përputhje me legjislacionin në fuqi, strategjitë përkatëse dhe standartet e shërbimeve sociale dhe ato të mbrojtjes së fëmijëve.
2. Të angazhohet në mbështetjen dhe fuqizimin e strukturës së NJMF-së në bashki dhe njësitë administrative duke prioritetizuar nevojat e fëmijëve dhe familjeve në nevojë për mbrojtje dhe në situatë emergjente.
3. Të planifikojë brenda buxhetit Bashkisë, buxhetin për shërbimet sociale duke parashikuar një linjë të vecantë për fëmijët në nevojë për mbrojtje/situatë emergjente.
4. Të angazhohet në pilotimin dhe mbështetjen e shërbimit me bazë komunitare pranë qendrës komunitare të bashkisë përmes pajisjes me staf të kualifikuar dhe burimet e nevojshme për funksionimin në vazhdimësi të shërbimit, si edhe zbatimit të modelit të ofruar nga Tdh.



4. Të mbështesë edukimin profesional për prindërit, si dhe për të rinjtë mbi 16 vjec në mënyrë që të jenë mëtëfuqizuar për punësimin në tregun e punës në përputhje me mundësitë që ai ofron
5. Të mbështesë një program prindërimi në bashkëpunim me shërbimet sociale në komunitet me fokus informimin mbi tema për prindërimin pozitiv dhe ngritjen e grupeve të mbështetjes së njëri-tjetrit.
6. Të mundësojë aktivitete të rregullta psikosociale nga animatorë të trajnuar për të lehtësuar integrimin e fëmijëve vulnerabël në shkollë dhe komunitet duke rritur aftësitë e tyre të reziliencës dhe aftësitë për jetën
7. Të mundësojë klasat për mbështetje mësimore të fëmijëve më vulnerabël për të mundësuar riintegrimin e tyre në sistemin arsimor dhe për të reduktuar stigmën dhe përjashtimin e fëmijëve të rikthyer nga migracioni
8. Të mundësojë kurse gjuhe për fëmijët e rikthyer nga migracioni për të përmirësuar komunikimin e fëmijëve dhe përfshirjen në sistemin arsimor
9. Të mbështesë grupet e edukatorëve bashkëmohatar në aktivitetet ndërgjegjësuese që ato përzgjedhin dhe funksionimin e tyre efektiv duke u trainuar dhe informuar mbi mobilizimin e të rinjve, lidhshmëri, duke zhvilluar aftësitë për jetën dhe aftësitë për organizimin e nismave dhe aktiviteteve me bashkëmohatarët
10. Të realizojë ngritjen e kapaciteteve për profesionistët që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, shfrytëzimi, trafikim përfshirë stafin e njësive administrative përmes trajnimeve formale dhe mbështetjes së profesionistëve përgjatë punës me anë të mentorimit gjysëm të strukturuar ose asistencës teknike përgjatë punës për proceset e menaxhimit të rastit për njësinë për mbrojtjen e fëmijëve dhe grupi multi-disiplinar të menaxhuara prej saj
11. Të mbështesë Bashkinë në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të vazhdueshme për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe parandalimin e abuzimit të fëmijëve, shfrytëzimit, trafikimit apo ekspozimit në migracion të pasigurtë
12. Të përcaktojë një punonjës nga organizata Tdh, i cili do të angazhohet drejtëpërdrejtë dhe do të jetë si pikë kontakti në komunikimet ndërmjet palëve për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

NENI 6

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë 3 vjeçare duke filluar nga dita e nënshkrimit të saj dhe do të jetë efektive përgjatë këtij afati.

Rishikimi i mëtejshëm do të jetë objekti i diskutimit të palëve të Marrëveshjes.

NENI 7

Zbatimi i marrëveshjes

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në koordinimin e të gjitha veprimeve dhe nismave që do të garantojnë përmbushjen dhe realizimin me sukses të saj.

NENI 8

Përfundimi i marrëveshjes

6.1 Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:

- a) mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në marrëveshje
- b) shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes
- c) palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes

6.2 Secila nga palët duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje;

6.3 Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negocimit dhe me mirëkuptim.

NENI 10

Dispozita të fundit

8.1. Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në zbatimin e saj duke punuar për realizimin e veprimtarive të përbashkëta.

8.2. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dy palët.

NENI 11

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe do të vijojë të zbatohet për një periudhë 3 vjecare.

Për Bashkinë e Shkodrës


Voltana Ademi

Kryetare



Për Terre des Hommes

Jezerca Tigani

Përfaqësuese Misioni



J.T.